

Nr. _____ Prot

Date ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

MBIKQYRJE PUNIMESH PER OBJEKTIN “Ndërtim i Rrjetit të Ri të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza të Lagjes Uznovë,Rajoni Nr.3 Bashkia Berat”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit **FPP71247000-1 – mbikqyrja e punes se ndertimit.**

Vlera e fondit limit: 2 781 027 (dy milion e shtateqind e tetedhjetë e një mijë e njëzetë e shtatë) leke pa Tvsh.

VKM nr 354 ,date 11.05.2016 , “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorri , projektim , mbikqyrje dhe kolaudim”

Në zbatim të ligjit 8402 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit ,udhëzimit të Keshillit Ministrave nr 3 ,date 15.02.2001,udhëzimit nr 1 date 22.02.2005,udhëzimit nr 1 date 16.06.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit

Kualifikohet oferta që në zbatim të udhëzimit të APP –se oferta e cila është më e vogël se vlera maksimale dhe ajo mbi vlerën minimale përfshihet dhe vlerën minimale të tarifave të VKM nr 354 ,date 11.05.2016 , “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorri , projektim , mbikqyrje dhe kolaudim”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Berat Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021 ,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres së fondit limit të kontrates që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "E Hapur e Thjeshtuar Shërbime", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe në procedurat e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2021 , 2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorezojë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës së fondit limit që prokurohet , të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

a) Kur kontrata eshte realizuar me institucione shtetërore, ofertuesi duhet të paraqesë kontraten e nenshkruar, vërtetim per realizimin me sukses nga institucioni me te cilin është lidhur kontrata te shoqeruar me faturen tatimore.

b) Kur kontratat jane te realizuara me subjekte private ofertuesi duhet te paraqese kontraten e nenshkruar dhe faturat tatimore ku te jene shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.5 Liçenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikeqyrje dhe Kolaudim punimesh zbatimi ku të përfshihen kategorite:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1 Punime gjermimi në tokë;
- N.P - 4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai...
- N.P-7 Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- N.P-12 Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S - 1 Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS - 18 Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqenese kemi të bëjmë me Mbikqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se Kategorite e mesiperme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit për Objektin Ndërtim i Shkolles 9-vjecare “22 Tetori”.

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, ose me kontrata sherbimi si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin ne liste pagesa ose , ose me kontrata sherbimi si më poshtë:

Inxhinier Gjeodet 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Licence profesionale dhe Cv si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqërisë per periudhen e kerkuar muajin e fundit .

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 6 (gjashte) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor per (muaji i fundit)

b) List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per (muaji i fundit)

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, ose ekuivalentet
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor) - ose ekuivalent

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave të references • Termat e References

- Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar nga specialist të fushës në bazë të V.K.M nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”., dhe janë marrë në konsideratë të tjerë elementet përberës të shërbimeve të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.

Njesia e Prokurimit

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Pelivan Sinaj